

KORNIZA E MODELIT TË SHËRBIMIT TË KUJDESIT AFATGJATË

LLOJI I SHËRBIMIT: KUJDESI NË BANESË PËR TË MOSHUARIT

Bashkia: Durrës

OJFja zbatuese: Udhëtim i Lirë – Liberi di viaggiare

1. Qëllimi i përgjithshëm

Të ofrojë kujdes të personalizuar dhe të integruar në banesë për të moshuarit me varësi funksionale në Bashkinë Durrës, duke ruajtur dinjitetin, pavarësinë dhe përfshirjen e tyre në komunitet, si dhe të nxisë punësimin e grupeve të marginalizuara si kujdestarë.

Prioritet kanë të moshuarit që frekuentojnë shërbimet e qendrës ditore të moshuarve Durrës. Në këtë qëndër do të jetë i vendosur dhe HUB ngritur më qëllim ndërlidhjen midis kujdestarëve të trajnuar me individët e moshuar dhe familjet e tyre, duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe punësimin në sektorin e kujdesit për të moshuarit. Individët e interesuar për shërbim në kujdestari ndaj moshës së tretë do të kontaktojnë përmes linjës telefonike të vendosur në dispozicionin për njësinë e ngritur -HUB- dhe pas vlerësimit të nevojës do të ofrohet shërbimi i kërkuar.

2. Elementët kryesorë të shërbimit

A. Parimet udhëheqëse

- Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut
- Qasje parandaluese dhe proaktive
- Barazia dhe mosdiskriminimi
- Pavarësia dhe parandalimi i institucionalizimit
- Plakje dinjitoze në shtëpi dhe komuniteti



Përfshirje komunitare

- Kujdesi jepet në ambjentin e jetesës së përfituesve, duke shmangur institucionalizimin.
- Bashkëpunim i ngushtë me institucionet vendore dhe familjet.

Zhvillim i kapaciteteve dhe qëndrueshmëri

- Krijimi i një Hub-i të Punësimit për kujdestarë, si një platformë e qëndrueshme ndërmjet punëkërkuesve dhe familjeve në nevojë. Hub-i/ njësia e punësimit e kujdestarëve/ ofrimit të shërbimit për individët në nevojë do të jetë e vendosur në Durrës, duke mbuluar me shërbim dhe zonat rurale dhe të funksionojë përmes një numri telefoni por fizikisht do të jetë e vendosur tek Qendra e të moshuave Durrës. Kjo qender do të ofrojë shërbime të drejtpërdrejta: gjetje pune, dhe ndihmë me dokumentet e nevojshëm që do të kërkohen nga punëdhënësit/punëmarrësit.
- Certifikim formal i kujdestarëve si garanci për cilësi dhe profesionalizëm.

Koordinim ndër-institucional

- Veprimtaria zhvillohet në partneritet me Bashkinë Durrës, Zyrën Rajonale të Punësimit (ZRP) dhe Qendrën Ditore për të Moshuar.
- Promovim i modelit të integruar të shërbimeve sociale.
- Identifikimi i kujdestarëve kryhet në bashkëpunim me ZRP dhe bashkinë Durrës, me prioritet nga listat e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike. Kujdestarët asistohen të përfitojnë nga skemat e nxitjes aktive të punësimit, si trajnimi profesional, program i punëve në komuniteti dhe program i riintegrit.

B. Modeli i shërbimit të kujdesit në familje

a) Profili i përfituesit

- Moshë mbi 65 vjeç.
- Me varësi funksionale të lehtë, mesatare ose të rëndë.
- Jeton i/e vetëm ose pa përkujdesje të mjaftueshme.
- Në kushte të vështira sociale dhe/ose ekonomike.



b) Shërbimet kryesore

NIVELI I KUJDESIT FREKUENCA SHËRBIMET

NIVELI I KUJDESIT	FREKUENCA	SHËRBIMET
KUJDES BAZË	1–2 herë/javë	Ushqim, pastrim, shoqërim, aktivitet fizik/social
KUJDES I MODERUAR	2–4 herë/javë	Higjienë personale, administrim i barnave, ndihmë në lëvizje
KUJDES INTENSIV	çdo ditë	Mbështetje për të gjitha nevojat bazë, menaxhim klinik, kujdes psikosocial.

c) Ekipi i kujdesit

- Kujdestar në banesë (trajnuar dhe certifikuar në bashkëpunim me AKPA)
- Infermier ose Mjek i familjes (në koordinim me QSSH-në përkatëse)
- Psikolog/punonjës social referuar nevojave të përfituesit ofruar nga aktorët bashkëpunues (Bashkia Durrës, Qëndrat Socio shëndetësore dhe Qëndrat Komunitare)

d) Hapat e zbatimit të shërbimit

1. Identifikimi i rastit – nga komuniteti, familjarët, Qendra Ditore, OJF ose Mjeku familjes;
2. Vlerësimi multidisciplinar – funksional, social, ekonomik, psikologjik;
3. Hartimi i planit të individualizuar të kujdesit;
4. Përzgjedhja e kujdestarit dhe trajnimi specifik;
5. Ofrimi i shërbimit në banesë sipas nivelit të nevojës;
6. Koordinim me QSSH dhe referim për nevoja shëndetësore të specializuara;
7. Monitorim dhe raportim mujor nga OJF/bashkia;
8. Vlerësim i kënaqësisë së përfituesit/familjarëve çdo 6 muaj.



e) Aktorët dhe rolet

STRUKTURA/AKTORI PËRGJEGJËSIA

STRUKTURA/AKTORI	PËRGJEGJËSIA
BASHKIA DURRËS	Identifikim rasteve, financim bashkëpunues, mbikëqyrje
QENDRA DITORE PËR TË MOSHUARIT	Referim dhe kontakt me komunitetin
ZYRA RAJONALE E PUNËSIMIT	Ndërmjetësim punësimi për kujdestarët, financim i programeve të nxitjes së punësimit.
QËNDRA SOCIO-SHËNDETËSORË	Referim lidhur me nevojën për kujdes shëndetësor në banesë
SHOQATA "UDHËTIM I LIRË-LIBERI DI VIAGGI-ARE"	Trajnim në etikë, kujdes geriatrik, mbështetje emocionale, trajtim PAK, përdorim i platformave digjitale, menaxhim dhe monitorim të kujdestarëve
KOMUNITETI	Sinjalizim i rasteve dhe mbështetje lokale
PARTNERËT MEDIATIKË	Bashkëpunim në zhvillimin e fushatës së ndërgjegjësimit publik, duke siguruar shpërndarjen e gjerë të informacionit mbi shërbimin e pilotuar të kujdesit në banesë për të moshuar dhe personave PAK

f) Mekanizmat e koordinimit

1. Takime mujore ndërmjet Bashkisë, OJF dhe Zyrës Rajonale e Punësimit
2. Platforma HUB për Kujdestarët, si pikë kontakti, regjistrimi dhe monitorimi
3. Protokoll i përbashkët referimi dhe vlerësimi i rasteve
4. Raportime periodike për cilësinë e shërbimit dhe kënaqësinë e përfituesve

3. Përfituesit e shërbimit

- Të moshuar (65+) që jetojnë vetëm ose pa mbështetje familjare të identifikuar nga aktorët përgjegjës.
- Të moshuar me sëmundje kronike, paaftësi fizike apo mendore.



- Persona në kushte të vështira sociale/ekonomike.
- 20 Kujdestarë të papunë të trajnuar nga grupe të marginalizuara (gra, të rinj, PAK).

Kriteret: Gjendja shëndetësore, funksionale, sociale dhe ekonomike – të vlerësuara nga njësia multidisiplinare.

4. Financimi

Buxheti total i projektit është 2.334.500 lekë, nga të cilat:

- 85% (1.984.325 lekë) financohen nga UNDP, dhe
- 15% (350.175 lekë) mbulohen nga Shoqata, si kontribut në bashkëfinancim

Fonde shtesë nga AKPA - Projekti i ri për riintegrimin social me Zyrën e Punës- 3.200.000 ALL

5. Pilotimi dhe shkallëzimi

- **Pilotimi fillestar:** Bashkia Durrës (110 përfitues dhe 20 kujdestarë)
 - Pas vlerësimit, mundësi shkallëzimi në gjithë qarkun.
-

6. Rezultatet e pritshme

- Cilësi e përmirësuar e kujdesit për të moshuarit dhe persona me aftësi të kufizuara në Bashkinë Durrës.
- 5 kujdestarë të trajnuar të punësuar në kujdesin në banesë.
- Zhvillim i profesionit “Kujdestarë për të moshuar” si mundësi reale punësimi dhe fuqizimi ekonomik i personave nga grupe të disavantazuara.
- Reduktim i izolimit social për moshën e tretë dhe personat me aftësi të kufizuara.

